

Parlamentet dhe Normalizimi

Hyrje

Beogradi dhe Prishtina mbesin të ngjuara në një status-kuo kompleks pas-konflikti tash e dy dekada. Dialogu i sponzoruar nga BE-ja i cili filloi në vitin 2011 ka përmirësuar marrëdhëniet dukshëm në fushat si liri e lëvizjes dhe tregti, po ka mbajtur bërthamën e konfliktit—statusin—nën qilim. Serbia insiston se nuk do t'a njohë pavarësinë e Kosovës në asnjë rrethanë, por thotë se është e gatshme t'i normalizojë marrëdhëniet me Prishtinën. Por Kosova insiston se normalizimi pa njohje nuk është i qëndrueshëm, për shkak se e lë konfliktin të hapur. Duke pasur parasysh këto qëndrime të papajtueshme, gjetja e nje modeli që do të kënaqte të dy palët do të jetë sfidues.

Ndonëse zyrtarisht nuk është ofruar ndonje opcion, shumë në Beograd dhe Prishtinë dhe në disa rrethe të vogla ndërkombëtare po diskutojnë zgjidhje të mundshme, nga 'ndryshimi i kufijve' e deri tek njohja e pavarësisë. Beogradi në vjeshtën e kaluar ka filluar një dialog nacional për gjetjen e një modeli për ta përmyllur konfliktin me Kosovën. Deri tani diskutimi është ngushtuar në 11 opsione, nga inkorporimi i Kosovës në Serbi deri tek njohja e pavarësisë.¹ Qeveria e Kosovës, në anën tjetër, ka hartuar një platformë për negociata, duke vendosur njohjen e pavarësisë nga Serbia si qëllim final të dialogut. Organizatat vendore dhe ndërkombëtare kanë zhvilluar skenare të ndryshëm, duke filluar nga njohja deri tek përtërirja e konfliktit.²

Ndonëse qeveritë udhëheqin negociatat, roli i parlamenteve në mbështetje dhe mbikëqyrje të procesit dhe ratifikimit të marrëveshjes finale është esencial. Në këtë kontekst, CIG ka mbledhur një numër deputetësh të parlamenteve të Serbisë dhe të Kosovës të cilët përfaqësojnë partitë kryesore politike për të diskutuar rolin e tyre në arritjen dhe ratifikimin e një marrëveshje përfundimtare. Diskutimi është mbajtur në Tiranë, Shqipëri, më 14 prill, 2018. CIG ka

¹ Dialogu i brendshëm ka përfunduar në prill të vitit 2018. Presidenti Serb Aleksandar Vucic planifikon të përpilojë një platformë të bazuar në rekomandimet e dialogut të brendshëm. Grupi punues i dialogut ka artikulluar 11 opsione: 1) ri-integrim të Kosovës në sistemin e Serbisë; 2) ndarje apo shkëmbim territorësh; 3) status-kuo; 4) vazhdim të dialogut të Brukselit; 5) konfederatë mes Serbisë dhe Kosovës; 6) zgjidhja e çështjeve ekonomike pa zgjidhje politike; 7) themelim i komunitetit të shteteve të Ballkanit; 8) Serbia dhe Kosova hyjnë në BE së bashku, Kosova si pjesë e Serbisë, duke lënë mënjane çështjen e statusit; 9) negociata nën patronatin ndërkombëtar—UN ose BE—bazuar në premisë të mos-njohjes; 10) Kosova si kondominium i bashkëqeverisur nga Shqipëria dhe Serbia; dhe 11) njohja e pavarësisë.

² Friedrich Ebert Stiftung, *Serbia dhe Kosova në 2035*; në dispozicion tek <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/14369.pdf>

organizuar aktivitete të tilla ndërmjet parlamentarëve në Prishtinë, Beograd, Podgoricë, Mavrovë dhe Bruksel gjatë tri viteve e gjysmë.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e një projekti më të madh mbi marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës i mbështetur nga dhe i implementuar në bashkëpunim me Departamentin Federal Zvicerran të Punëve të Jashtme.

Raporti bazohet në diskutimet e tryezës e mbajtur nën rregullin e Chatham House. Jemi munduar të jemi të saktë dhe të balansuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit komentet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë në plotëni në këtë raport të shkurtër.

Modelet e normalizimit

Përkundër shumë mangësive, procesi i Brukselit ka vendosur disa themele kritike për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Prosesi ka transformuar marrëdhëniet nga ‘një konflikt i ngrirë në një shkrirës.’ Kështu që faza tjetër e negociatave mbi normalizim gjithpërfshirës tanimë ka një bazë solide. “Problemi është që ne nuk kemi përvojë në negociata ku japim dicka në shkëmbim të dickaje tjetër, prandaj na nevojitet bashkësia ndërkombëtare të na shtyjë drejtë kompromisit,” tha njëri nga deputetët. Disa nga folësit serbë insistuan që zgjidhja të gjendet përbrenda kornizës kushtetuese të Serbisë, në formë të autonomisë substanciale. Por, pjesëmarrësit Kosovarë thanë se Prishtina mund ta diskutojë vetëm njohjen me Beogradin. “Gjithqka më pak se njohja e lë konfliktin të hapur.” Shumë parashikuan si rezultat më të mundshëm një model që do të lejonte normalizimin e marrëdhënieve pa njohje.

Një pjesëmarrës serb tha se marrëveshja e ardhshme gjithpërfshirëse do të konfirmonte diçka që është realitet, që nënkupton “njohjen implicite të Kosovës nga Serbia.” “Ne nuk jemi duke kërkuar zgjidhje, jemi duke kërkuar mënyrë për ta zyrtarizuar zgjidhjen.” Një folës tjetër nuk u pajtua, duke thënë se “Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën qoftë në mënyrë implicite apo eksplicite, madje edhe nëse kjo do të nënkuptonte jo anëtarësim në BE për Serbinë.” “Ne mund të flasim vetëm për çështje siç janë ekonomia dhe tregtia, asgjë më tepër,” përfundoi ai.

Vullneti politik dhe interesi vetanak janë përbërësit kryesor për të arritur një marrëveshje. Shumë folës thanë se Prishtina dhe Beogradi kanë vullnet solid politik dhe, që është edhe më e rëndësishme, shumë interes vetanak për ta zgjidhur konfliktin, por që pajtimi i qëndrimeve diametrikisht të kundërta kërkon më shumë sesa ‘vullnet solid,’ kërkon ‘vullnet të fuqishëm.’ Asnjëra palë nuk është e gatshme të bëjë hapa të guximshëm; të dy palët kërkojnë që pala tjetër të bëjë atë çfarë vetë nuk është e gatshme ta bëjë.” Për shembull, folësi shtoi, Prishtina kërkon nga Beograd të kërkojë falje për krimet kundër popullatës shqiptare, por Prishtina nuk është e gatshme ta bëjë të njëjtën për serbët e Kosovës. “Ne të gjithë e dimë se çfarë hapa kërkohen por ngurrojmë t’i ndërmarim sepse nuk janë të pranueshëm për votuesit tanë.” Një folës tjetër tha se krimet kundër shqiptarëve kanë qenë “institucional,” përderisa ato ndaj serbë janë “bërë nga individë.” Një folës u përgjigj se “pak ka rëndësi për viktimat nëse vendimi për vrasje të tyre ka qenë “institucional apo individual.” “Të gjitha viktimat meritojnë kërkim-falje.”

Bashkësia ndërkombëtar është munduar ta ndihmojë Beogradin dhe Prishtinën që të arrijnë një zgjidhje që kënaq të dy palët, por deri më tani rezultate janë të përziera. Të dy palët madje janë të pakënaqura edhe me procesin e Brukselit. “Edhe Prishtina edhe Beogradi ndiejnë se kanë humbur më shumë sesa që kanë fituar nga dialogu i Brukselit.” Sidoqoftë, shumë thënë se një opcion ku “të dy palët ndjehen njësoj humbës gjithashtu është adekuat.” “Ne nuk mund të pajtohemi me një model ku njëra palë merr gjithçka e pala tjetër humb gjithçka,” tha një folës serb. Pjesëmarrësit nuk arritën të pajtohen me një model që do të mund t’i kënaqte apo dëshpëronte të dy palët barabar.

Presidenti Serb Vucic vjeshtën e kaluar tha se një zgjidhje e lehtë do të ishte njohja, por shtoi se Beogradi nuk mund t’a bëjë këtë. Në vend të kësaj, Beogradi organizoi një dialog kombëtar tetë-mujor mbi Kosovën rezultatet e të cilit Presidenti Vucic do ti artikuloj në një platformë për negociim të një marrëveshje përfundimtare. Në Serbi, marrëveshja finale me Prishtinën duhet t’i nënshtrohet “vullnetit të popullit” nëpërmjet një referendumi. Në Kosovë, ratifikimi i marrëveshjes finale kërkon dy të tretat e parlamentit. Një numër i pjesëmarrësve Kosovarë thanë se edhe në Kosovë është i nevojshëm një dialog i brendshëm apo ndër-partiak lidhur me marrëveshjen finale me Serbinë.

Nëse zgjidhjet e lehta nuk janë në tavolinë, cilat janë zgjidhjet jo lehta? Deputetët patën mospajtime substanciale edhe mbi zgjidhjet jo të lehta. Pjesëmarrësit Kosovarë thanë se ‘zgjidhja e lehtë’ është ‘e vetmja zgjidhje.’ Disa folës serbë thanë se ‘njohja’ nuk është temë diskutimi dhe se zgjidhja duhet të kërkohet përbrenda ‘normalizimit pa njohje.’ Njohja e Kosovës, sipas një numri të folësve, nuk është opcion i mundshëm, të paktën jo për një kohë afat-shkurtër apo afat-mesme. Gjithashtu, disa thanë se njohja e Kosovës nga Serbia nuk është aq e rëndësishme siç edhe tingëllon. “Njohja nga Serbia nuk garanton ulëse në KB, anëtarësim në BE, ose njohjen e Kosovës nga pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën. “Ekzistojnë kritere tjera për anëtarësim në BE, ulësja në KB varet nga Rusia, pesë anëtarët e BE-së që nuk e njohin Kosovën për shkak të çështjeve të tyre të brendshme, jo për shkak të solidaritetit me Serbinë.” Duke pasur parasysh këto qëndrime të papajtueshme, shumë folës parashikuan se një marrëveshje finale nuk mund të arrihet shpejtë dhe se ‘procesi gradual’ ekzistues do të mbetet *modus operandi*.

Vonimi i marrëveshjes ka pasoja edhe për Beogradin dhe për Prishtinën. Për të hyrë në BE deri më 2025, Serbia duhet t’i përmbush të gjitha kriteret deri më 2023 dhe të arrijë marrëveshje finale me Kosovën deri më 2021, më së voni, shpjeguan disa folës. Një marrëveshje finale me Serbinë gjithashtu është esenciale për hapat e më tutjeshëm të Kosovës drejt integritetit në BE, veçanërisht në lehtësimin e pozicionit të pesë mos-njohësve të BE-së. Shumica e folësve thanë se Prishtina dhe Beogradi janë ende në rrugën e duhur për të arritur marrëveshjen e ‘normalizimit pa njohje’ në kohë.

Por çka nënkupton ‘normalizimi pa njohje’? Serbia tanimë ka njohur dokumentet e identifikimit të Kosovës, targat e automjeteve, vulat doganore, pikat kufitare, kodin telefonik, dhe ka bërë marrëveshje mbi energjinë. Disa pjesëmarrës thanë se Serbia mund të njoh institucionet e Kosovës—siç janë policia dhe gjyqësori—dhe dokumente tjera—siç janë pasaportat—dhe të mos llobojë kundër anëtarësimin të Kosovës në organizata ndërkombëtare. “E tëra kjo mund të bëhet pa nevojën që Serbia ta njohë Kosovën.”

Por çka do të përfitonte Serbia në këtë rast, pyeti një folës serb. Shumë deputetë serbë thanë se marrëveshja finale duhet të jetë një lloj pazari. Nëse Kosova merr njohje implicite, atëher Serbia do duhej të merrte diçka të barasvlefshme. Shumë folës thanë se anëtarësimi në BE nuk është i mjaftueshëm. Disa thanë që një Asociacion/Komunitet i fuqishëm i komunave me shumicë serbe në shkëmbim të njohjes do të ishte ‘transaksion i drejtë,’ por folësit Kosovarë kundërshtuan çfarëdo fuqie ekzekutive për Asociacionin/Komunitetin, duke argumentuar se do të “minonte sovranitetin e Kosovës.” Në anën tjetër, disa folës serbë thanë se edhe një Asociacion/Komunitet i fuqishëm nuk mjafton si shkëmbim për njohje implicite.

Kishte konsensus se është në interes të Serbisë dhe të Kosovës të zgjidhet konflikti. Por të dyja palët kanë vështirësi të baraspeshojnë interesin vetanak me parimet e vjetra dhe sentimentin. Shumë thanë që është në interesin e Serbisë ta mbyllë konfliktin me Kosovës me një formë të njohjes implicite, por njohja bie në kundërshtim me parimin e mbajtur me dekada se “Kosova është pjesë e pandashme e Serbisë,” dhe ka shumë gjasa që t’i “zemëroj më shumë njerëz sesa që udhëheqësia do të mund të përballonte.” Gjithashtu është në interes të Kosovës të pajtohet me një llojë ‘normalizimi pa njohje’ por kjo bie në kundërshtim me parimin se ‘vetëm njohja është normalizim.’ Politikanët Kosovarë gjithashtu druajn se formimi i Asociacionit/Komunitetit do të “zemëronte më shumë njerëz sesa që ata mund të përballojnë.”

Mbetet të shihet nëse interesi vetanak do të mbizotërojë mbi parimet dhe sentimentin apo e kundërta. Interesi mbizotëroi në dialogun në Bruksel në një masë të konsiderueshme.

Interesi më i dukshëm dhe i prekshëm për Serbinë është ekonomia. Për kokë banori, Kosova është importuesi më i madh i Serbisë. Një Kosovar importon mallra në vlerë rreth 150 euro në vit nga Serbia dhe vetëm rreth 40 euro nga Shqipëria. Në krahasim, një rusë importon vetëm rreth 7 euro nga Serbia. Normalizimi i marrëdhënieve është e vetmja mënyrë që Serbia të ruaj dhe të rrit eksportin e saj në Kosovë, tha një folës. Për Kosovën, Serbia dikur ka qenë treg i rëndësishëm, por është ndërprerë që nga lufta. Por tani që shumë pengesa teknike dhe politike janë hequr, Kosova mund të rimarr një pjesë të tregut.

Pjesëmarrësit pranuan rëndësinë e përfitimeve ekonomike nga normalizimit, por ata theksuan se faktorët jo-ekonomikë, siq janë sentimentin dhe identiteti, do të vazhdojnë të mbesin forca të fuqishme në formësimin e zgjidhjes. Fushatat publike, transparenca, dhe retorika racionale u sugjeruan si mjete për ta zvogëluar sentimentin nationalist dhe për të fituar mbështetjen publike për zgjidhje racionale.

Një folës konsideroi se është “udhëheqësia jo kompetente në Serbi dhe Kosovë” që është duke minuar procesin. “Dialogu është komprometuar nga bartësit e tij.” Ai sugjeroi që serbët dhe shqiptarët duhet të transformojnë të kuptuarit e kompromisit. “Ne i kuptojmë kompromiset si humbje.” Folësi theksoi se kompromisi mund të gjendet edhe në kornizën e Ahtisaarit. Një folës tjetër tha se, “ne të gjithë kemi dëshmuar se dijmë çfarë duhet bërë për të dështuar, por tani është koha të mësojmë se çfarë duhet bërë për të arritur sukses.” Folësi sugjeroi se serbët dhe shqiptarët duhet të bejnë vet më shumë për të arritur një zgjidhje. “Unë nuk krenohem që shefja e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, duhet të kërkojë zgjidhje për problemet tona,” duke shtuar se, “përderisa ne nuk e kemi në dorë të ardhmen tonë, udhëheqësit tanë do të na konsiderojnë thjeshtë si vulë gome.”

Klima e krijuar nga të dy elitat udhëheqëse në Kosovë dhe Serbi nuk është e favorshme për arritje të marrëveshjeve të suksesshme. Në vend që të mobilizojnë opinionin publik për dialogun, vetë elitat janë duke helmuar atmosferën. Të dy ekipet negociuese kanë nevojë për përmirësim, sipas shumë folësve.

Folësit konkluduan se Prishtina dhe Beogradi nuk mund të kenë parime dhe objektiva të përbashkëta, por që kjo nuk do duhet të jetë arsyeja për vonim të zgjidhjes. “Ne nuk duhet t’iu lëmë problemin gjeneratave të ardhshme.” Një folës parashikoi se një marrëveshje është e pashmangshme para vitit 2021 dhe se ka shumë gjasa që “të dyja palët do të ndjehen humbës.” Folësi shtoi se qëllimi i kompromisit duhet të jetë paqja dhe stabiliteti në rajon dhe marrëdhëniet e qëndrueshme në mes Prishtinës dhe Beogradit. Sidoqoftë, ai parashikoi se lloji i zgjidhjes varet më shumë nga fuqitë e mëdha sesa nga Beogradi dhe Prishtina.

Një realitet kompleks

“Serbia duhet ta njoh realitetin se Kosova është vend i pavarur,” tha një folës. “Kosova duhet ta njoh realitetin që nuk e kontrollon veriun me shumicë serbe,” iu përgjigj një folës tjetër. “Realiteti Kosovar” duket që përbëhet nga një numër i ‘realiteteve më të vogla.’ Serbia nuk e kontrollon Kosovën, por Kosova nuk e kontrollon pjesën e saj veriore. Një folës tha se, “zyrtarët policorë në veri kanë ndërruar uniformat por jo zingjirin komandues,” se së pari i raportojnë Beogradit e pastaj Prishtinës. Një realitet tjetër është se Kosova nuk mund ta integrojë veriun pa mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e BE-së pa arritur një marrëveshje me Prishtinën. “Prandaj një marrëveshje është e pashmangshme,” shpjegoi një folës.

“Jemi duke u ballafaquar me një marrëdhënie të ndërvarur ku të gjithë kanë nevojë për të gjithë.” Negociatat janë të pashmangshme për të ndërprerë bllokimin. Një folës tha se Prishtina dhe Beogradi kanë dy mundësi: të vazhdojnë status-kuon ose të arrijnë një kompromis. “E kuptojë që nuk është e lehtë për Kosovën të bëjë kompromise, por nuk është e lehtë as për Serbinë.” Disa folës shpjeguan që ka qenë e vështirë për Beogradin që të pajtohet me marrëveshjet mbi menaxhimin e integruar të kufirit, vulave postare, dhe kodit telefonik, prerogativa që i kanë vetëm shtetet e pavarura.

Në realitetin ekzistues, Beogradi nuk ka kontroll në shumicën e Kosovës, por ka shumë ndikim në veri. “Është e pasaktë kur shumë thonë që nëpërmjet Asociacionit/Komunitetit, Prishtina do t’i jepte veriun Serbisë,” tha një folës, duke shtuar se “Serbia tanimë veç e ka veriun.” Asociacioni/Komuniteti ndoshta mund ti ndihmojë Prishtinës të shtrijë pak autoritet atje. Nuk do t’i integronte tërësisht komunat veriore por do të “transformonte ndarjen de fakto në një ndarje të butë.” Veriu gjithashtu ka shumë përparësi për shkak të liqenit të Gazivodës.³

³ I ndodhur në komunën e Zubin Potokut, Liqeni Gazivoda është i burimi më i rëndësishëm i ujit në Kosovë dhe aseti kyc i hidro-sistemit Iber Lepenc. Gazivoda përmban 69 përqind të ujit akumulues të Kosovës. Në krahasim, Radoniqi, liqeni artificial më i madhi në jug të vendit, përmban vetëm 20 përqind, pasuar nga Batllava me 5.3 përqind dhe Badofci me 4.6 përqind. Gazivoda është përdorur gjithashtu në të kaluarën si levë, vecanërisht në vitin 2007 kur u bë e qartë që Kosova do të shpallë pavarësinë. Autoritetet

Alternativat nuk janë atraktive. Konflikti i ngrirë do ti mbante ekonomitë e tyre dhe rrugëtimin drejt integritimit në BE të ngrira gjithashtu. Kostoja e konfliktit tanimë është e lartë. Serbia dhe Kosova janë në mesin e më të varfërave në Evropë, qytetarët e tyre ikin për Evropën Perëndimore në numër të madh, dhe demokracitë e tyre mbesin të dobëta. Investimet e jashtme direkte në Kosovë dhe Serbi janë të papërfillshme. Shumë kompani ndërkombëtare hezitojnë të investojnë në vende me çështje të pazgjidhura politike dhe sundim të dobët të ligjit.

“Shumica e popujve tanë jetojnë në kushte mizore, duke shërbyer si burim i lirë për treg të punës, dhe përdoren e abuzohen nga sektori publik edhe privat,” tha një folës. “Është turp për të gjithë ne të mos bëjmë asgjë vetëm pse kemi frikë nga kompromisi.”

Shumë prej folësve ishin skeptik se Prishtina dhe Beogradi do të jenë në gjendje të pajtohen për një marrëveshje finale. Si pasojë, ata thanë se komuniteti ndërkombëtar do të ketë nevojë që të imponoj një marrëveshje. Arritja e një marrëveshje kërkon kompromise nga të dy palët, tha një folës. “Marrëveshjet janë transaksione, duhet të japësh diçka për të marrë diçka.” Por folësit nuk u pajtuan më atë se si duhet të duket ai transaksion.

Shumë folës thanë se është koha për veprim, “të bëhet çfarë duhet bërë, jo vetëm të flitet për atë se çfarë duhet bërë.” Zyrtarë nga Prishtina dhe Beogradi tanimë flasin për dy dekada lidhur me atë çfarë duhet bërë, por nuk kanë ndërmarrë hapa të nevojshëm për të arritur një marrëveshje. Disa folës thanë se kërkesa e komunitetit ndërkombëtar është e qartë: Serbia duhet ta njoh autoritetin e Kosovës, jo gjithsesi pavarësinë e saj, dhe se Kosova duhet të formojë Asociacionin/Komunitetin. Detyrat e Serbisë janë të listuara në Kapitullin 35 të kornizës së saj negociuese me BE-në, përderisa Kosova është zotuar të zbatojë marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjeve të pazgjidhura, shumë folës ishin skeptik se një marrëveshje gjithpërfshirëse do të arrihet së shpejti. “Normalizimi gjithpërfshirës duhet të mbulojë fushat e mbrojtjes, sigurisë, transportit ajror, që janë vetëm disa nga çështjet e hapura, e Prishtinës dhe Beogradit do t’iu duhen vite për të rënë dakord në këto çështje të ndjeshme.” Disa shtuan se bisedimet për ndarje janë gjithashtu duke komplikuar procesin. Një numër i akterëve thanë që diskutimet mbi ndarje të mundshme tanimë janë duke ndodhur në rrethe më të ngushta. “Serbia nuk flet më për Kosovën, por për veriun e Kosovës.” Përderisa motivet e tij janë të paqarta, disa folës raportuan se Presidenti i Kosovës Hashim Thaci thuhet se mbështet shkëmbimin e territorit si opcion, por shumë nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania, mbesin fuqishëm kundër.

Kosovare kërkuan nga KFOR-i të marrë kontrollin e Liqenit për të siguruar që menaxhmenti Serb nuk e ndërpreu furnizimin me ujë si përgjigje ndaj shpalljes së pavarësisë. Menaxhmenti serb ndërpreu rrjedhën e ujit në vitin 2000, por vetëm për 10 minuta. Uji vecanërisht është i rëndësishëm për prodhim të energjisë. Termocentralet nuk do të mund të operojnë pa ujin e Liqenit. Një raport i UNMIK-ut në vitin 2007 vlerësoi se në qoftë se menaxhmenti Serb ndërpreu furnizimin me ujë, “Kosova do të ketë rrymë vetëm për institucionet kyce.”

Disa folës thanë se ndarja klasike ku Serbia merr veriun e Kosovës nuk ka gjasë të ndodhë, por një “ndarje e butë” është duke u bërë realitet. Nën çfarëdo skenari, një folësi parashikoi se veriu do të mbesë nën kontroll de facto të Serbisë, por de juro institucionet në veri do të funksionojnë sipas kornizën ligjore të Kosovës. Shkëmbimi i territoreve nuk është një opcion i mundshëm. Mund të fillojë me Kosovën dhe Serbinë, por është shumë e mundshme të përfundoj me “Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë.”

Përfundim

Ka pasur pajtim të gjerë lidhur me diagnozën e konfliktit por jo për recetën. Por edhe pse pjesëmarrësit nuk janë pajtuar me ndonjë përmbajtje të marrëveshjes, ata kanë pasur parasysh koston që vazhdimi i konfliktit ka për të dyja pakët, Serbinë dhe Kosovën.

Marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës janë të ndërvarura. Asnjëra nuk mund të shkojë përpara pa e zgjidhur konfliktin. Serbia duhet t’ a heq çështjen e Kosovës nga agjenda për të ecur përpara me integrimin në BE, përderisa Kosova duhet të arrijë një marrëveshje me Serbinë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe ndoshta të përmirësojë marrëdhëniet me pesë mosnjohësit e BE-së.

Përfundimi i konfliktit me ndonjë llojë traktati të paqës, i pabesueshëm disa vite më parë, tanimë është duke u bërë i paevitueshëm. Dhe përderisa status-kuo nuk është e favorshme për asnjërën palë, shumë thanë që është racionale për udhëheqësit politik të marrin përsipër rreziqe duke pranuar terme që mund të mos jenë popullore për publikun tani, por që sentimenti do të ndryshonte kur përfitimet e zgjidhjes fillojnë të bëhen të dukshme.

Ratifikimi dhe zbatimi i marrëveshjes mund të jetë po aq i vështirë sa arritja e saj. Shumë deputetë thanë se nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në proces, dhe se negociatat nuk janë transparente, dhe se u kërkohet të votojnë pa pasur informacion të mjaftueshëm. Ata thanë që parlamentet duhet të luajnë një rol më të madhë në fazën e ardhshme.

Pjesëmarrësit

Gordana Čomić, Deputete në Parlamentin e Serbisë, Partia Demokratike
Illir Deda, Deputet në Parlamentin e Kosovës, Alternativa
Blerta Deliu Kodra, Deputete në Parlamentin e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Aida Derguti, Deputete në Parlamentin e Kosovës, Grupi i Deputetëve të Pavarur
Vladimir Đukanović, Deputet në Parlamentin e Serbisë, Partia Progresive Serbe
Vladimir Đurić, Deputet në Parlamentin e Serbisë, Mjaftë është Mjaftë
Dubravka Filipovski, Deputete në Parlamentin e Serbisë, Partia Progresive Serbe
Arben Gashi, Deputet në Parlamentin e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Enver Hoti, Deputet në Parlamentin e Kosovës, NISMA Social Democrate
Donika Kadaj Bujupi, Deputete në Parlamentin e Kosovës, AAK
Nada Lazić, Deputete në Parlamentin e Serbisë, Lidhja e Social Demokratëve të Vojvodinës
Snežana Paunović, Deputete në Parlamentin e Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Dejan Radenković, Deputet në Parlamentin e Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Korab Sejdiu, Deputet në Parlamentin e Kosovës, i pavarur
Xhelal Sveçla, Deputet në Parlamentin e Kosovës, Vetëvendosje
Armend Zemaj, Deputet në Parlamentin e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Belul Beqaj, Analist
Shpetim Gashi, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
Milivoje Mihajlović, Analist
Igor Novaković, Përfaqësues në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
Kuno Schläfli, Këshilltar për Siguri Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës